



NË NJË VËSHTRIM

2026



Banka Evropiane
e Investimeve | Grupi



NË NJË VËSHTRIM

2026



Banka Evropiane
e Investimeve | Grupi

2026 në një vështrim

© **Banka Evropiane e Investimeve, 2026**

98-100 Bulevardi Konrad Adenauer
L-2950 Luksemburg

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Të gjitha pyetjet mbi të drejtat dhe licencimin duhet të dërgohen në publications@eib.org.

Për informacione të mëtejshme lidhur me aktivitetet e BEI-t, ju mund të konsultoheni me faqen e internetit www.eib.org. Gjithashtu, mund të kontaktoni në adresën info@eib.org. Merrni buletin tonë elektronik në www.eib.org/sign-up.

© Meritat e fotos: Grupi BEI, Inelfe, Nokia, Alfredas Pliadis, Shutterstock, Jolt.

Klauzolë

Në rast mospërputhjeje ndërmjet këtij përkthimi dhe variantit në gjuhën angleze, varianti në gjuhën angleze duhet të prevalojë.

Botuar nga Banka Evropiane e Investimeve.
Printuar në letër FSC®.

RRETH GRUPIT TË BANKËS EVROPIANE TË INVESTIMEVE

Grupi i Bankës Evropiane të Investimeve luan një rol kyç duke mbështetur një Evropë të fortë në një botë më të qëndrueshme dhe paqësore.

Me një vlerë rekord prej 100 miliardë eurosh të financuar në vitin 2025, Grupi i BEI-t ofron kredi afatgjata për qindra projekte të mëdha dhe të vogla çdo vit përmes Bankës Evropiane të Investimeve. Ai gjithashtu mbështet kompanitë inovative me rritje të shpejtë përmes Fondit Evropian të Investimeve.

I themeluar në vitin 1958 së bashku me Bankën Evropiane të Investimeve, dhe në pronësi të 27 anëtarëve të Bashkimit Evropian, Grupi i BEI-t i alokon rreth 10% të huadhënies së tij projekteve përtej Bashkimit Evropian, në më shumë se 160 vende. Ne kontribuojmë në progresin global si një anëtar kryesor i familjes së bankave shumëpalëshe të zhvillimit. Kjo punë krijon partneritete të forta në interes të të dy palëve.

Duke marrë parasysh madhësinë e tij, portofolin e diversifikuar dhe partneritetet e ngushta, Grupi i BEI-t mbështet platforma dhe instrumente financiare që përmirësojnë tregjet e kapitalit në Evropë dhe mobilizojnë financim shtesë nga investitorët institucionalë.

Grupi i BEI-t është një simbol i suksesit të Evropës. Ne u dërgojmë një mesazh besimi dhe qëndrueshmërie njerëzve, bizneseve, investitorëve dhe tregjeve financiare. Në Evropë dhe në mbarë botën.

NDIKIMI YNË NË VITIN 2025

FINANCIME TË
GRUPIT TË BEI-T **100**
miliardë EUR

Duke përfshirë **9** miliardë EUR
përtej Bashkimit Evropian

Nënshkrimet e FONDIT
EVROPIAN TË
INVESTIMEVE 2025 **16**
miliardë EUR

20,6 miliardë EUR Qytete dhe rajone të
qëndrueshme

33 miliardë EUR Siguria energjetike në
Bashkimin Evropian

57 miliardë EUR Masa për klimën dhe
qëndrueshmëria mjedisore

27,8 miliardë EUR Obligacione të gjelbra dhe
të qëndrueshmërisë

10,3 miliardë EUR Infrastruktura sociale

22,4 miliardë EUR Financimi i "TechEU"

4 miliardë EUR Siguria dhe mbrojtja

29,7 miliardë EUR Financimi i mbështetur nga asistenca këshillimore

26,8 milionë njerëz me ujë të pijshëm më të sigurt

9,2 milionë njerëz me kushte higjienike më të mira

18,5 milionë njerëz që mbrohen më mirë nga thatësitrat

6,9 milionë njerëz që mbrohen më mirë nga përmbytjet

PRIORITETET TONA

Çdo vit, Grupi i BEI-t financon qindra projekte të reja që mbështesin përparësitë e Bashkimit Evropian: masat për klimën, teknologjia, strehimi i përballueshëm, siguria dhe mbrojtja, bujqësia dhe shumë sektorë të tjerë. Puna jonë krijon mundësi në të gjithë Evropën, përshpejton financimin e qëndrueshëm, promovon zhvillimin e tregjeve të kapitalit dhe mbron praninë e fortë globale të Evropës.



Interkonektori i Gjirit të Biskajës është një projekt historik që do të rrisë kapacitetin e energjisë elektrike midis Gadishullit Iberik dhe pjesës tjetër të Evropës.

BANKA PËR KLIMËN

Grupi i Bankës Evropiane të Investimeve është pararojë e tranzicionit drejt energjisë së pastër. Ne nxisim investime që ulin emetimet e gazrave serrë në kompani të të gjitha madhësive. Dhe financojmë projekte që ndihmojnë komunitetet të përshtaten me një të ardhme në ndryshim.

11,6 miliardë EUR në rrjete energjetike dhe magazinim

1 trilion EUR në projekte për klimën dhe mjedisin nga viti 2020 deri në vitin 2030

DYFISHIMI I ENERGJISË

Banka Evropiane e Investimeve po jep 1,6 miliardë EUR hua për të mbështetur një interkonektor të energjisë elektrike në Gjirin e Biskajës, të zhvilluar nga “Red Eléctrica de España” dhe “RTE Réseau de transport d’électricité”. Projekti do të dyfishojë kapacitetin mes Francës dhe Spanjës, duke ofruar energji më të sigurt dhe të përballeshme për miliona njerëz.



2

**Këto teknologji janë thelbësore për
rritjen e performancës dhe efikasitetit
të energjisë, si dhe të sigurisë
kibernetike të sistemeve celulare.**

NOVACIONI

Në vitin 2025, Grupi i BEI-t lançoi programin "TechEU", programin më të madh të financimit ndonjëherë për inovacionin teknologjik në Evropë. Programi do të ofrojë financim me vlerë 70 miliardë euro përmes kredive, borxhit sipërmarrës dhe kapitalit deri në vitin 2027, duke mobilizuar investime me vlerë 250 miliardë euro. I nxitur nga kjo qasje ambicioze ndaj teknologjive shkatërruese dhe ndërmarrja e rreziqeve më të larta, financimi për inovacionin - me qëllim forcimin e lidershitit teknologjik të Evropës - u rrit në një vlerë rekord prej 22,4 miliardë EUR.

4,1 miliardë EUR investime në AI

INTELIGJENCA ARTIFICIALE CELULARE

Nokia do të përdorë një kredi prej 870 milionë EUR nga Banka Evropiane e Investimeve për të zhvilluar rrjete celulare të gjeneratës tjetër. Kompania do të punojë në sisteme të njohura si "5G-Advanced" dhe "6G", duke përforcuar lidershipin teknologjik të Evropës në komunikimet celulare.



3

Kreditë “Indra” dhe “Thales” do të nxisin zhvillimin e teknologjive më të përparuara dhe do të mbështesin mijëra hulumtues e inxhinierë.

SIGURIA DHE MBROJTJA

Grupi i BEI-t investon në paqen dhe sigurinë e Evropës. Ky financim u vjen në ndihmë firmave inovatore dhe bizneseve të konsoliduara që të avancojnë në projekte që mbrojnë njerëzit e kufijtë. Nga satelitët te zgjidhjet e sigurisë kibernetike, infrastruktura dhe dislokimi ushtarak, ne mbështesim ide që e bëjnë Evropën të sigurt dhe e ruajnë nga ndërhyrjet.

Viti 2025 solli një ndryshim të madh në mbështetjen për sigurinë dhe mbrojtjen, ku u financuan më shumë se

4 miliardë EUR

SIGURIMI I KRAHUT LINDOR

Grupi i BEI-t po përforcon kapacitetin ushtarak të Lituaniës, duke përfshirë investime prej 540 milionë EUR dhe mbështetje këshillimore për një bazë ushtarake pranë kufirit Lituani-Bjellorusi. Ai do të presë një brigadë gjermane, duke forcuar aftësitë e reagimit të shpejtë të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) në rajon.

Grupi gjithashtu po ofron rreth 1 miliard euro për të financuar programet kërkimore të dy prej grupeve kryesore të mbrojtjes në Evropë, përkatësisht "Indra" dhe "Thales". Kjo do të mundësojë ndërtimin e objekteve të reja dhe do të përshpejtojë kërkimin dhe zhvillimin e mbrojtjes, teknologjive hapësinore dhe aeronautikës për fluturime civile dhe ushtarake.



4

Ky projekt modernizimi ka dhe një qëllim të rëndësishëm që ka të bëjë me rritjen e qëndrueshmërisë së rrugëve ndaj ndryshimeve klimatike.

KOHEZIONI

Ne investojmë në projekte kohezioni që zvogëlojnë pabarazitë rajonale në Bashkimin Evropian dhe fuqizojnë komunitetet më pak të begata. Kjo promovon rritje të barabartë dhe i ndihmon njerëzit të kenë sukses kudo që jetojnë, në mënyrë që të mos u duhet të largohen nga vendi i tyre në kërkim të mundësive më të mira.

42,8 miliardë EUR për financimin e kohezionit në vitin 2025

REZULTATE KONKRETE

Në vitin 2025, BEI investoi rreth 1,4 miliardë EUR për të modernizuar autostradat në rajonet më pak të zhvilluara të Polonisë. Investimet me bankën Gospodarstwa Krajowego nxisin aktivitetin ekonomik dhe zhvillimin rajonal, duke mbështetur njëkohësisht dislokimin ushtarak dhe civil në vend. Këto projekte u mbështetën nga asistenca këshillimore që identifikoi pjesët e rrjetit që kanë më shumë nevojë për përmirësim.



5

Për punonjësit e sektorit publik që kujdesen për mbarëvajtjen e qyteteve, strehimi është një nga sfidat më urgjente.

INFRASTRUKTURA SOCIALE

Financimi ynë social përmirëson jetën në qytet, rrit strehimin e përballueshëm dhe shton shërbimet publike. Ai mbështet investime, të cilat ndihmojnë njerëzit të mësojnë aftësi të reja dhe të kujdesen për të sëmurët e të moshuarit. Kjo hedh themelet për rritje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme në të gjithë Evropën.

10,3 miliardë EUR investime në infrastrukturën sociale në vitin 2025

HEDHJA E THEMELEVE

Grupi i BEI-t planifikon të ndihmojë në shtimin e rreth një milion shtëpive të përballueshme dhe të qëndrueshme deri në vitin 2030. Me një kredi prej 60 milionë eurosh, një nga bankat pararojë të Çekisë, Česká spořitelna, po financon më shumë se 1000 shtëpi të përballueshme në Pragë për infermierë, mësues dhe punonjës të tjerë thelbësorë. Një kredi prej 1,3 miliardë EUR do të mbështesë strehimin e përballueshëm në Portugali. Irlanda lançoi një instrument kreditimi me vlerë 400 milionë EUR për të ofruar financim afatgjatë me normë fikse për ofruesit e strehimit social. Erste Bank e Austrisë përfitoi 200 milionë EUR për kryerjen e investime në strehim, duke përfshirë projekte për të rinjtë dhe qiramarrësit e moshuar.



6

Sektori i bujqësisë përbën një nga shtyllat kryesore të ekonomisë dhe të identitetit të Italisë.

BUJQËSIA DHE BIOEKONOMIA

Bujqësia është thelbësore për sigurinë tonë ushqimore, cilësinë e ushqimit dhe ekonomitë. Ne financojmë projekte në peshkim, pyje, cilësi ushqimore, zhvillim rural dhe prodhim të qëndrueshëm ndaj ndryshimeve klimatike. Kreditë dhe shërbimet tona këshillimore përmirësojnë jetesën e fermerëve, mbrojnë mjedisin dhe ulin emetimet bujqësore.

6,9 miliardë EUR investime për bujqësinë dhe bioekonominë në vitin 2025

NJË BREZ I RI FERMERËSH ITALIANË

Grupi i BEI-t po i jep një hua prej më shumë se 100 milionë eurosh Banca di Asti, një bankë rajonale në Italinë veriperëndimore, për të ndihmuar në financimin e fermerëve të rinj dhe kompanive të vogla të bioekonomisë. Të paktën 10% e financimit të Banca di Asti do të shkojë për fermerët e rinj.



7

Banka po ndihmon në riparimin e më shumë se 500 ndërtesave publike në rreth 150 komunitete në të gjithë Ukrainën.

INVESTIME GLOBALE

Ne po ndërtojmë partneritete më të forta që u shërbejnë të gjithëve në të gjithë botën. Ne e mbështesim Ukrainën në mënyrë aktive dhe promovojmë zhvillimin e qëndrueshëm në rajone të tilla si Mesdheu dhe Afrika Sub-Sahariane. Ne kontribuojmë në masat për klimën dhe në objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të OKB-së. Ne jemi një nga huadhënësit më të mëdhenj në sektorin global të ujit.

Tre të katërtat e investimeve të BEI-t përtej Bashkimit Evropian mbështetën projektet e “Global Gateway”.

SI TA MBAJMË UKRAINËN NË LËVIZJE

Duke qenë se nevojat e financimit gjatë dekadës së ardhshme vlerësohen në 524 miliardë USD, Ukraina është një përparësi kryesore për Bankën Evropiane të Investimeve. Përtej ndihmës emergjente, Grupi i BEI-t është i fokusuar në fusha që mund të bëjnë ndryshimin më të madh sa më shpejtë. Në vitin 2025, Grupi i Bankës Evropiane të Investimeve mbështeti projekte me vlerë 1,5 miliardë EUR për të ndihmuar familjet të ngrohin shtëpitë, t'i mbajnë fëmijët në shkollë dhe të sigurojnë që njerëzit të marrin kujdes mjekësor.



8

Kthimi i aseteve në letra me vlerë të tregtueshme mbështet drejtpërdrejt objektivat e unionit të kursimeve dhe investimeve.

UNIONI I KURSIMEVE DHE INVESTIMEVE

Me dizajn pan-evropian, Grupi i BEI-t është pionier në instrumentet financiare që do të shërbejnë si "bloqe ndërtimi" drejt një unioni të vërtetë kursimesh dhe investimesh. Përmes rolit të tij të rëndësishëm në nxitjen dhe grumbullimin e investimeve private, Grupi i BEI-t po kanalizon kursimet drejt kampionëve evropianë të teknologjisë, inovatorëve, sipërmarrjeve private dhe bankave më të vogla. Integrimi më i mirë i tregjeve të kapitalit do të mundësojë hyrjen e investimeve dhe kursimeve në të gjithë Bashkimin Evropian, nga e cila do të përfitojnë individë, investitorë dhe kompani.

Një union kursimesh dhe investimesh do ta ndihmojë Evropën të shfrytëzojë të gjitha mundësitë e tregut të saj të brendshëm.

DHURATË RRITJEJE

Banka Evropiane e Investimeve po investon në kthimin e aseteve në letra me vlerë të lëshuara nga bankat evropiane dhe po zhvillon struktura inovative të letrave me vlerë për të mbështetur më shumë biznese që janë jetësore për ekonominë reale. Duke mbështetur bankat inovative përmes investimeve në kthimin e aseteve në letra me vlerë, Grupi i BEI-t ndihmon në krijimin e një tregu investimesh më likuid dhe më të madh. Transaksioni sintetik i kthimit të aseteve në letra me vlerë prej 1 miliard eurosh nga ABN AMRO në vitin 2025 përbën letrën me vlerë më të madhe të mbështetur ndonjëherë nga Grupi i BEI-t. Është gjithashtu një hap i madh për Bankën Evropiane të Investimeve dhe Fondin Evropian të Investimeve, i cili strukturon transaksionet e kthimit të aseteve në letra me vlerë.

RRETH FONDIT EVROPIAN TË INVESTIMEVE

Fondi Evropian i Investimeve është instrumenti i specializuar i Grupit të BEI-t që ndihmon bizneset e vogla të rriten. BEI u jep garanci kredie bankave për t'i ndihmuar të investojnë në bizneset evropiane dhe punon me fonde kapitali sipërmarrës, kredi private dhe fonde kapitali privat dhe infrastrukture për të gjeneruar mbështetje për sipërmarrësit novatorë.

Fondi Evropian i Investimeve u krijua në vitin 1994 për ta bërë financimin më të arritshëm për bizneset e vogla. Ai ndihmon kompanitë në faza të ndryshme të zhvillimit, nga faza fillestare deri në zgjerimin ndërkombëtar. Qëllimi është të krijohet një ekosistem më i mirë për investimet në biznes në Evropë, por edhe FEI kontribuon në inovacion, konkurrencë, ndikim social dhe qëndrueshmëri.

Më shumë se **15,7 miliardë EUR**
të zotuar në vitin 2025 për qëndrueshmëri,
ndikim social, inovacion dhe rritje

FEI mbështet novatorët në fazat e hershme që të zhvillojnë zgjidhjet e së nesërme dhe bizneset e konsoliduara që të zgjerohen në sektorë të rinj dhe të guximshëm.



RRITJE GLOBALE, NDIKIM EVROPIAN

Fondi Evropian i Investimeve investoi 260 milionë EUR në fondin “Jolt Capital”, duke e mbështetur firmën me seli në Paris që të mbledhë investime të mëtejshme deri në 800 milionë EUR nga e gjithë bota për të mbështetur kompanitë evropiane të teknologjisë së thellë. Investimi i FEI-t është pjesë e Nismës Evropiane të Kampionëve të Teknologjisë, e cila trajton hendekun e shkallëzimit të Evropës me investime në fonde të mëdha kapitali sipërmarrës.



NË NJË VËSHTRIM

2026



Banka Evropiane
e Investimeve | Grupi



Mësoni më shumë rreth
prioriteteve strategjike
të Grupit të BEI-t.